



## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

### NDËRMJET

#### DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PRONËSISË INDUSTRIALE (DPPI)

#### DHE

#### AGJENCISË SË SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR (ASCAP)

Me qëllim nxitjen e zhvillimit në fushën e shkencës dhe teknologjisë dhe inkurajimit të punës shkencore dhe kërkimore në Republikën e Shqipërisë, nëpërmjet:

- rritjes së ndërgjegjësimit të nxënësve, të stafit pedagogjik dhe institucioneve arsimore në përgjithësi, për të drejtën autorit;
- krijimit dhe vënies në dispozicion të tyre të një sistemi efektiv të informimit për arritjet e mëparshme (shpikjet) në fushat e ndryshme të shkencës;

lidhet kjo Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet palëve:

**Drejtorja e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI)** me seli në adresën: Bulevardi “Zhan D’Ark”, Prona nr. 33, Shtëpia e Ushtarakëve, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm znj. Rovena Beqiraj

dhe

**Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Para-universitar (ASCAP)** me seli në adresën: Rruga Naim Frashëri, Nr.37, Tiranë 1049, Shqipëri, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm Z. Gerti Janaqi;

Duke qenë se:

DPPI është institucioni përgjegjës për regjistrimin, administrimin dhe promovimin e të drejtave të Pronësisë Industriale në Republikën e Shqipërisë, midis të cilave dhe të drejtat e shpikësve mbi: Shpikjet dhe Modelet e Përdorimit; Disenjot Industriale, Topografitë e Produkteve Gjysmëpërçues. DPPI është institucioni që krijon, ruan dhe administron bazën e të dhënave për këto objekte të

Pronësisë Industriale, si dhe institucioni i vetëm përgjegjës, për zhvillimin e politikave për promovimin e këtyre të drejtave;

dhe

ASCAP, misioni i të cilit është që t'i ofrojë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe institucioneve arsimore të të gjitha niveleve, ekspertizë dhe këshillim në nivel profesional, të mbështetur në rezultatet e punës kërkimore-studimore dhe praktikës së arsimit.

### **Neni 1**

#### ***Qëllimet dhe synimet***

Objekti i kësaj marrëveshjeje është bashkëpunimi ndërmjet palëve për:

- a. Rritjen e ndërgjegjësimit të nxënësve, të stafit pedagogjik dhe institucioneve arsimore në përgjithësi, si dhe të vetë shpikësve dhe profesionistëve të përfshirë në punë kërkimore e shkencore në fushën e arsimit lidhur me rëndësinë e mbrojtjes së të drejtave të Pronësisë Industriale, si të drejta që u takojnë ekskluzivisht shpikësve dhe që u sjellin atyre, përveç përfitimit moral, edhe përfitim ekonomik, si rezultat i shfrytëzimit të shpikjeve në industri.
- b. Krijimin e infrastrukturës së nevojshme për vënien në dispozicion të nxënësve, të stafit pedagogjik si dhe shpikësve e krijuesve në fushën e arsimit, të informacioneve periodike për arritjet e mëparshme në fushat e ndryshme të teknologjisë (shpikjet e bëra publike) si dhe të informacionit të nevojshëm në lidhje me të drejtat ligjore që gëzojnë shpikësit dhe mënyrat ligjore për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

### **Neni 2**

#### ***Veprimtaritë***

Palët, në përmbushje të përgjegjësive të tyre, vënë në zbatim iniciativat e dobishme për të arritur qëllimin e, veçanërisht përmes zhvillimit të aktiviteteve të përbashkëta si seminare, konferenca, ekspozita, trajnime të ndryshme që kanë për qëllim ndërgjegjësimin të nxënësve, të stafit pedagogjik dhe institucioneve arsimore për rëndësinë dhe rolin që ka mbrojtja ligjore e të drejtave mbi shpikjet në zhvillimin e shkencës dhe teknologjisë në vend. Këto aktivitete përfshijnë:

- përgatitjen e materialeve informuese dhe promovuese;
- shkëmbimin e informacionit dhe publikimeve të ndryshme;
- Trajnimin e vazhdueshëm të stafit pedagogjik në fushën e pronësisë industriale
- Çështje të tjera me interes të përbashkët.

### **Neni 3**

#### ***Përgjegjësitë e palëve***

- a. Marrëveshja hartohet dhe pranohet nga palët, duke nënkuptuar se asnjë pjesë e saj nuk është në tejkalim ose kundërshtim të dispozitave përkatëse ligjore, mbi të cilat palët mbështesin ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave e tyre;
- b. Palët zotohen të zbatojnë vullnetarisht dhe në kushte mirëbesimi këtë marrëveshje, për sa parashikohet në të. Mosmarrëveshjet zgjidhen me mirëkuptim. Në rast të kundërt, secila nga palët mund të tërhiqet dhe të ndërpresë në mënyrë të njëanshme marrëveshjen

### **Neni 4**

#### ***Burimet financiare***

Marrëveshja do të realizohet në bazë të zërave financiarë të parashikuar në buxhetet ekzistuese të palëve dhe pa sjellë shpenzime shtesë për palët.

### **Neni 5**

#### ***Personat e kontaktit***

Palët bien dakord të caktojnë personat e kontaktit, për ndjekjen dhe zbatimin e marrëveshjes në mënyrë shkresore, menjëherë pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje dhe sa here që kërkohet zëvendësimi i tyre.

### **Neni 6**

#### ***Kohëzgjatja***

Kjo marrëveshje është e vlefshme për një periudhë 5 (pesë-vjeçare), duke nisur nga data e nënshkrimit të saj dhe me mirëkuptim ndërmjet palëve, mund të ndryshohet dhe/ose të zgjatet në përfundim të afatit të vlefshmërisë së saj. Ndryshimet dhe shtesat do të bëhen me shkrim dhe me miratim, ndërmjet Palëve.

Shfuqizimi në mënyrë të njëanshme i kësaj marrëveshjeje, mund të bëhet në çdo kohë nga secila prej palëve, por duke lajmëruar me shkrim 30 (tridhjetë) ditë më parë, palën tjetër.

**Neni 7**  
**Interpretimi**

Interpretimet e ndryshme të tekstit të kësaj marrëveshjeje do të zgjidhen miqësisht mes palëve, të cilat do të kontaktojnë drejtpërdrejt me njëra-tjetrën.

Marrëveshja e bashkëpunimit hartohet në 2 (dy) kopje identike dhe do të nënshkruhet në Tiranë, më datë 23.03.2023.

**Për Drejtorinë e  
Përgjithshme të Pronësisë  
Industriale (DPPi)**

**Znj. Rovena Beqiraj**



**Për Agjencinë e Sigurimit të  
Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)**

**Z. Gerti Janaqi**

